



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.377/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mejreme Ismajli nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, paraqitur kundër Qendrës së Votimit (QV), në Vushtrri, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET si e palejuar** ankesa ZL.Anr.377/2017 e datës 23.10.2017 e Mejreme Ismajlit nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri.

## A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga e Mejreme Ismajli nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, me të cilën pretendon se në bazë të të dhënave nga menaxheri i qendrës së votimit, në ditën e zgjedhjeve me 22 tetor 2017, ka marur gjithësej 12 vota, mirëpo në bazë të deklaratave bindëse të disa votuesve të PDK-së në QV-në 2731b , thekson se ka marrë së paku 25 vota, por që gjatë numërimit votat e saj i janë shpërndarë kandidatëve të tjerë ose ka mundur të ndodhë ndonjë gabim gjatë numërimit të votave. Me këtë rast parashtruesja e ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në të gjitha vendvotimet në atë qendër votimi.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi

që ta hedh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 377/2017 me datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli**

Rafet Haxhaj



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP.***